



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË  
FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT  
TË UJËRAVE TË NDOTURA  
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR**

**VENDIM**

**Nr. 40, datë 01.06.2018**

**PËR LICENCIMIN E SH.A UJËSJELLËS KANALIZIME TROPOJË**

Në zbatim të nenit 14, pika 1/a, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence", si dhe Rregullores së licencimit miratuar me vendim të KKRR nr. 29 datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar dhe pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Teknike Ekonomike, mbi aplikimin e shoqërisë sh.a Ujësjiellës Kanalizime Tropojë për licencim për efekt përfundimit të afatit, Komisioni Kombëtar Rregullator,

**Konstatohet se:**

- Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Tropojë është licencuar për herë të fundit nga Komisioni Kombëtar Rregullator me vendimin nr. 15 datë 13.06.2012 "Për rinovim licence Ujësjiellës Kanalizime Tropojë" me vlefshmëri 4 vjeçare deri në datë 13.06.2016;
- Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Tropojë me anë të shkresës nr. 45 prot. të datës 18.05.2018, ka aplikuar pranë ERRU për licencim për arsye të përfundimit të afatit të licencës, shtim të kategorisë së largimit të ujërave të ndotura si dhe zgjerim të zonës së shërbimit.
- Aplikimi i shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Tropojë plotëson kërkesat e parashikuara në Rregulloren e Licencimit për përfundimin e afatit të licencimit, konkretisht:
  - Formati i aplikimit është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;
  - Janë bërë ndryshimet përkatëse në ekstraktin e QKB mbi emrin e subjektit, zgjerimin e zonës së shërbimit dhe shtimin e shërbimit të largimit të ujërave të ndotura;

- Dokumentacioni juridik dhe administrativ është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator,

**VENDOSI:**

1. Licencimin e operatorit sh.a Ujësjellës Kanalizime Tropojë me:  
Drejtues Ligjor dhe Drejtues Teknik Z. Hysni Breçani
2. Operatori sh.a Ujësjellës Kanalizime Tropojë autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategorinë:  
Kategoria A, Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;  
Kategoria C, Për largimin e ujërave të ndotura.
3. Zona e shërbimit të këtij operatori është Bashkia Tropojë;
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4 (katër) vjeçare.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

**K R Y E T A R I**

**Ndriçim SHANI**